**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**AKADEMIA E SHKENCAVE**
**KRYESIA**

**Nr. 199 prot.** **Tiranë, më 02.02.2026**

# Vendim

**nr. 13 datë 02.02.2026**

## Për ringritjen e Njësisë afatshkurtër të kërkim-studimit në fushën e inteligjencës artificiale

Bazuar në nenet 4 dhe 19 të ligjit nr. 59/2019 "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; në nenin 44 të statutit të ASHSH, i ndryshuar; me kërkesë të bashkëdrejtuesit të Njësisë, akad. Neki Frashëri (bashkëngjitur); me propozim të Seksionit të Shkencave të Natyrore dhe Teknike, në shkresën "Kërkesë për rinovimin e Njësisë kërkimore të përkohshme të inteligjencës artificiale", me nr. prot. 1743, datë 14.11.2025 (bashkëngjitur); pas njohjes me relacionin mbi aktivitetin e saj për periudhën 2023-2025 dhe me propozimet për veprimtarinë shkencore, për periudhën 2026-2027, Kryesia e ASHSH-së në mbledhjen e saj të datës 02.02.2026,

## Vendosi:

1. Të ringrejë Njësinë kërkimore afatshkurtër të kërkim-studimit në fushën e inteligjencës artificiale edhe për dy vite të tjera, duke filluar nga data e marrjes të këtij vendimi.

2. Grupi drejtues i Njësisë të ketë përbërjen si më poshtë:

   - Akad. Arjan Durrësi, ASHSH (drejtues shkencor)
   - Akad. Neki Frashëri, ASHSH (bashkëdrejtues)
   - Prof. Betim Çiço, EPOKA (anëtar)
   - Akad. asoc. Kozeta Sevrani, FEUT,UT (anëtar)
   - Prof. Elinda Kajo, FTI,UPT (anëtar)
   - Prof. Ana Ktona, FSHN,UT (anëtar)
   - Dr. Erarda Vuka, UMSH (anëtar)



Akademia e Shkencave e Shqipërisë, sheshi "Fan Noli", Tiranë; tel.: 0(4)222 7476; email: neki.frasheri@akad.gov.al; www.akad.gov.al

- Dr. Romina Muka, Akademia e të Rinjve, ASH (anëtar)

3. Propozimi i paraqitur nga akad. Neki Frashëri për veprimtarinë e njësisë kërkimore të *inteligjences artificiale* në dy vitet në vijim (bashkëngjitur), të shërbejë si program i përkohshëm i saj.
4. Brenda muajit shkurt 2026 grupi drejtues të paraqesë për miratim programin përfundimtar të punës së kësaj Njësie, me specifikime të plota të projekteve, konferencave, botimeve dhe nisma të tjera shkencore, për dy vitet në vazhdim.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: drejtuesit e Njësisë së kërkim-studimit të *inteligjencës artificiale*, sekretari shkencor, kryetari i SSHNT dhe kancelari.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Akad. Skënder GJINUSHI**

**KRYETAR**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AKADEMIA E SHKENCAVE



Akademia e Shkencave e Shqipërisë, sheshi "Fan Noli", Tiranë; tel.: 0(4)222 7476; email: neki.frasheri@akad.gov.al; www.akad.gov.al